

NË EMËR TË POPULLIT

P. nr.2/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm– Gjyqtari i vetëm gjykues Gëzim Ademi, me procesmbajtësen Hasnije Muhaxheri, në çështjen penale kundër të pandehurit M.P nga Mitrovica me vendbanim ne ...-..., për shkak te veprës penale: Shkaktim i rrezikut te përgjithshëm nga neni 365 par.8 lidhur par.6 e par.1 te KPRK-se dhe veprës penale: Përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 375 par 1 te KPRK, sipas Aktakuzës se P.TH. ne Mitrovica PP.II.nr.30/15 te datës 03.01.2019, pas mbajtjes se shqyrtimit fillestar me dt. 21.02.2019, ne mungese të PTH Sahit Tmava, e në prezencë te av. K.B e te pandehurit ne te njëjtën dite ka shpallur publikisht, ndërsa me 12.03.2019 ka përpiluar këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri M.P, nga i ati B. e ëma Z. e vajzërisë M. i lindur më ... në ..., me vendbanim ...-..., Serb Shtetas i Republike se Kosovës, me numër personal ..., i martuar, babai një fëmije, i pa pune, ka te kryer shkollën e mesme, i gjendjes se dobët ekonomike nga se askush ne familje nuk punon.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE: I. Me dt.22.12.2013 rreth orës 15:30 minuta, i pandehuri me automjetin e tij te markës Peugeot ka shkuar ne fshatin ..., ndërmarr një veprim te rrezikshëm, dhe me armen e vet-pushkën e gjuetisë e markës IZ 27 EM, prodhim Rus me nr. serik 102730997, ashtu qe ka shtëne dy here ne qenet endacak, duke rrezikuar jetën e njerëzve dhe personave qe banojnë ne këtë fshat, nga kjo gjuajtje një thaqme ka fluturuar ne drejtim te dëmtuarit J.Zh i cili ne ato momente ishte duke shëtitur, e ka goditur ne pjesën e përparme te fytyrës dhe ne dorën e majte, nga e cila goditje i dëmtuari ka pësuar lëndime te renda trupore dhe atë: plage nga arma e zjarrit ne regjionin e majte te fytyrës, një trup i huaj ne regjionin e majte ethmoidal te sinusit nazal, trup i huaj ne pjesën e jashtme te kokërdhokut te syrit te majte, plage e hapur ne regjionin e gishtërinjve te dorës se majte, trup i huaj ne regjionin e dorës se majte., trup i huaj ne regjionin e traktit respirator, ndrydhje te indeve te buta ne regjionin e kokës dhe regjionin e shpinës, dëmtime këto qe bëjnë pjese ne dëmtime te renda trupore me pasoja te përjetshme ne shëndet.

Me këtë ka kryer veprën penale: **Shkaktim i rrezikut te përgjithshëm nga neni 365 par.8 lidhur par.6 e par.1 te KPRK-se**

II. Me dt. 22.12.2013 rreth orës 15:30min., i dyshuari me automjetin e tij te markës Peugeot ka shkuar ne fshatin ..., dhe me armen e vet-pushkën e gjuetisë e markës IZ 27 EM, prodhim Rus me nr. serik 102730997 te cilin e ka mbajture ne mënyrë ta pa autorizuar e ka përdorë duke gjuajtur dy here ne qenet endacak qe ndodheshin ne këtë fshat.

Me këtë ka kryer veprën penale: **Përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 375 par. 1 te KPRK-ës**

Andaj gjykata ne mbështetje te nenit 7,8,9,10,21,50,51,52,73, dhe 365 par 8 lidhur par 6 e par 1 dhe neni 375 par 1 te KPRK-ës dhe nenit 365, 450,463,te KPP-ës i:

G J Y K O N

Për veprën penale si ne piken I te dispozitivit te aktakuzës, me **ME DENIM BURGU NE KOHEZGJATJEJE PREJ 6 (muajve)**, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale ne kohëzgjatjeje prej 1 (një) viti.

Për veprën penale si ne piken II te dispozitivit te aktakuzës, **ME DENIM BURGU NE KOHEZGJATJEJE PREJ 1 (vit)**, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale ne kohëzgjatjeje prej 1 (një) vite.

Në baze të nenit 80 par.2 nenpar.2.2, te akuzuarit i;

S H Q I P T O N

DENIMIN UNIK ME BURGIM ne kohëzgjatje prej një (1) vite e katër (4) muaj, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale ne kohëzgjatjeje prej 2 (dy) viti.

Ne mbështetje te nenit 375 par.3 e lidhur me nenin 69 te KPRK-se, dhe nenit 282 par.2 nenpar.2.1 te KPP-se, te pandehurit i shqiptohet:

DENIM PLOTESUES

Konfiskohet arma- pushkë e gjuetisë e markës IZ 27 EM, prodhim Rus me nr. serik 102730997

OBLIGOHET i pandehuri te paguaj për Ekspertizën mjeko-ligjore 20euro, ne emër te shpenzimeve procedurale-paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 30 Euro, si dhe ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te krimit shumen prej 30 euro, te cilat shpenzime i pandehuri është i obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar për Kërkesë pasurore-juridike udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

A r s y e t i m

I. Aktakuza

Prokuroria Themelore ne Mitrovice ka ngritur aktakuze PP-II.nr. 30/15 te datës 03.01.2019 kundër te pandehurit M.P, për shkak te veprës penale: Shkaktim i rrezikut te përgjithshëm nga neni 365 par.8 lidhur par.6 e par.1 te KPRK-se dhe veprës penale: Përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 375 par 1 te KPRK.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt. 21.02.2019 ashtu qe ne këtë seance i pandehuri lidhur me fajësinë ka deklaruar ndjej vetën fajtor për te dy veprat penale qe me vihen ne barr dhe i premtoj gjykatës se nuk do te përsëris vepra tjera penale dhe se kjo është hera e fundit, dhe me vjen keq për rastin qe ka ndodhur..

Lidhur me pranimin e fajësisë prokurori pranimi i fajësisë nga ana e te pandehurit mbështetet te provat materiale nga te cilat është ngritur aktakuza, i cili pranim është ber ne mënyrë vullnetare e pa kurrfarë presioni nga ana e te njëjtit paraprakisht pas njoftimit nga ana e

gjykatës me favoret dhe disfavoret që kanë të bëjnë me pranimin apo mos pranimin e fajësisë. Andaj nga kjo që u theksua i propozoj gjykatës që ta bëjë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, duke pasur parasysh në rastin e dënimit në të gjitha rrethanat renduese dhe lehtësuese të parapara me ligj kurse pranimin e fajësisë ta marrë si rrethanë lehtësuese.

Mbrojtësi i të pandehurit Av. K.B lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi:

Pranimin e fajësisë i akuzuari e ka bërë me vullnet të plot pa kurrfarë presioni dhe kërcënimin nga as kush. Andaj konsideroj se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Lus gjykatën që në rastin e vendosjes për llojin dhe peshën e dënimit të ketë parasysh sipas vlerësimit të vet të gjitha rrethanat ekzistuese të natyrës së rëndë atyre të natyrës së lehtë. Nga se në konsiderojmë se në çështjen konkret nuk ekziston asnjë rrethanë të natyrës renduese. Përkundrazi të gjitha provat në dispozicion shpiten apo drejtojnë në përfundim se kjo veprë është e rastit dhe se të njëjtën ai nuk e ka dëshiruar fare. Nga rrethanat lehtësuese konsideroj se gjykata duhet të ketë parasysh të vlerësoi sidomos faktin se i akuzuari ka qenë korrekt dhe kooperues me Organet e zbulimit të ndjekjes edhe tani nga gjykata. Ai qenka inicim i procedurës penale pa kurrfarë luhaje ka pranuar veprën penale gjë që ka bërë edhe gjatë procedurës duke përfshirë këtë seancë. Si rrethanë lehtësuese sipas vlerësimit tone duhet vlerësuar fakti se i akuzuar ndërkohë është martuar, dhe se është baba i një fëmije. Pastaj në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë person relativisht i ri se, se kjo është hera e parë e gjer me tani e fundit që ka rënë në konflikt me ligjin, e sidomos pendimin e tij të sinqertë për kryerjen e kësaj veprë penale. Njekosisht lus gjykatën si rrethanë lehtësuese të ketë parasysh edhe gjendjen e tij të dobët ekonomike dhe se ai është personi i vetëm i cili kujdeset për ekzistencën, e gjithë anëtarëve të familjes së tij në punë private në cilësi të automekanikut. Bazuar në këto rrethana propozoi gjykatës që ndaj të mbrojturit tim të shqiptoj një dënim simbolik.

I. Vlerësimi i pranimin të fajësisë.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte në përputhje me nenin 248 pasi që i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë i pandehuri e bën në mënyrë vullnetare, pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës, se aktakuza nuk përmban shkelje të qartë ligjore apo gabime faktike që do të bënin të pamundur që gjykata të bëjë vlerësimin e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është i mbështetur në faktet e çështjes që përmban akuza, të gjitha këto për gjykatën përveç se vërtetojnë faktet e çështjes se akuzës njëkohësisht janë në përputhje me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit, këto rrethana vërtetohen nga provat që gjenden në shkresat e lëndës si: Kallëzimin penal me nr. të rastit ..., Raportet policore, dëshmia e të dëmtuarit, dëshmia e të pandehurit, vërtetimi mbi sendet e konfiskuara të dt.22.12.2013, raporti i ekspertizës nga agjensioni i Kosovës për forenzik të dt. 16.11.2018, ekspertiza mjeko-ligjore e Dr. N.U e dt. 09.10.2017, foto dokumentacioni, nga të gjitha këto si dhe nga pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit vërtetohet se i pandehuri i ka kryer veprat penale: Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga nenin 365 par.8 lidhur par.6 e par.1 të KPRK-së dhe veprës penale: Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga nenin 375 par 1 të KPRK.

II. Vlerësimi lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh nenin 73 të KPRK-së, andaj duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese, kjo gjykatë si rrethanë renduese ka

gjetur shkallen e përgjegjësive penale rrethanat në të cilat ishte kryer vepra penale. Si rrethane lehtësuese gjykata ka gjetur rrethanat personale të kryerësit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, kohën e kryerjes së kësaj vepre penale ku nga koha e kryerjes kishte kaluar një kohë e gjatë, gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë e që nga deklarimi i tij me rastin e pranimit të fajësisë rezultoi se i njëjti deklaroi se në ndien veten fajtor ky deklarim i tillë i të pandehurit për gjykatën shpreh një pendim të thellë të tij për veprën penale. Po ashtu edhe nga evidenca e të dënuarve nuk rezultoi se ky i pandehur ka kryer ndonjë vepër penale e as nuk zhvillohet ndonjë procedurë penale.

Nga të gjitha këto gjykata duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit ndaj të pandehurit pasi që për gjykatën në rrethana të tilla mjafton se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimeve, do të ndalojë kryerësin që të mos kryej vepra penale në të ardhmen e që ky është edhe qëllimi i dënimit me kusht. Nga të gjitha këto rrethana kjo gjykate vlerëson se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit ndaj të pandehurit.

Gjykata ka aplikuar dispozitat ligjore lidhur me shqiptimin e dënimit plotësues, ashtu që në bazë të dispozitës 375 par 3 në lidhje me nenin 69 të KPRK-së, ku përcaktohet se armët që përdoren apo mbahen në kundërshtim në rrethana dhe kushtet për lejen e armës të njëjtat konfiskohen, e në këto rrethana gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

III. Lidhur me shpenzimet e procedurës penale.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur që të pandehurin ta detyroj për Ekspertizën mjeko-ligjore 20euro, në emër të shpenzimeve procedurale-paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 Euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 euro, të cilat shpenzime të pandehuri është i obliguar që të paguaj në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

V. Lidhur me kërkesën pasurore juridike.

I dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridik-kompensimin e dëmit udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 248, 365, 450, të KPPK-ës nga arsyeje të lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm

P. nr.2/2019 dt.12.03.2019

Procesmbajtësja :
Hasnije Muhaxheri

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gëzim Ademi

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë në ankese në afat prej 15 ditëve në gjykatën e Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.